



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.44/2019

Prishtinë, më 7 shkurt 2019

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Sylja, Fisnik Ismaili dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Sasha Milosavljeviç, Mexhide Mjaku-Topalli, Saranda Bogujevci dhe Veton Berisha.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinators dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Shkëlqim Mehmetaj-KDI, Drita Vitia-Radio Kosova, Mirjeta Duraku-Kosovapress, Kujtesa Bajrami-RTV21, Valmira Saraqi-KTV, Blerta Aliu-KDI dhe Zana Ulaj, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1.Diskutim lidhur me mundësinë që Burgu i Prishtinës të shndërrohet në muze.

1. Diskutim lidhur me mundësinë që burgu i Prishtinës të shndërrohet në muze

Kryetarja, tha se sot si pikë e rendit të ditës është diskutimi lidhur me mundësinë që burgu i Prishtinës të shndërrohet në muze. Ne, brenda komisionit, kemi biseduar disa herë për këtë çështje, që burgu në Prishtinë ka qenë burg i torturës, burg politik, është një kërkesë me vend, për të mos harruar vuajtjet e shumë veprimtarëve, siç janë: Adem Demaçi, Fazli Grajqevci,

Rexhep Mala, e shumë të tjerë. Do të bëjmë një kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë, te Kryeministri, te Kryetari i Kuvendit dhe në shumë adresa të tjera.

Luljeta Veselaj- Gutaj, tha se ky është një moment shumë i rëndësishëm, edhe pse i vonuar, por besoj që tani duhet të kemi kujdes të veçantë për këtë temë. Të gjithë e dimë që në këtë burg gjatë viteve '90-ta janë mbajtur të burgosur dhe janë maltretuar qytetarë të Kosovës, në mënyra të ndryshme nga regjimi serb, duke filluar prej ikonave, siç është Adem Demaçi dhe shumë të tjerë, shpresoj që të gjitha institucionet përgjegjëse do t'i japin mbështetje kësaj çështjeje. Edhe pse është diskutuar paraprakisht në takimet e komisionit, që të shndërrohet pavijoni C në burgun e Dubravës, sigurisht që ka pasur pengesa në atë çështje, mirëpo edhe më mirë është që burgu i Prishtinës të bëhet muze, sepse Prishtina është kryeqendër dhe ka shumë vizitorë dhe ta dijë gjithë bota, të shohin nga afër torturat që u janë bërë popullit shqiptar, kemi shumë argumente për të treguar. Unë i jap mbështetje dhe besoj të finalizohet, ashtu siç është planifikuar.

Teuta Haxhiu, tha se kjo kërkesë është në kohën e duhur, por kërkoj që të mos tjetërsohen ato gjurmë që janë pjesë e historisë së dhimbshme e ikonave të shtetit të Kosovës. Për vuajtjet e tyre në ato hapësira, aq sa kemi informata, që ajo pjesë është duke u rrënuar dhe nuk e dimë se çka mund të ndodhë dhe gjithë atë material që e kemi për të gjithë të burgosurit, ta shpalojmë në ato hapësira, në mënyrë që gjeneratat, por edhe kushdo që viziton Kosovën, të shohë gjurmët e dhunës që ka përjetuar populli shqiptar.

Shemsi Sylja, përveç kërkesës që të shndërrohet burgu i Prishtinës në muze, duhet të kërkojmë nga të gjitha instancat, të cilat kanë obligim ruajtjen dhe konservimin e gjithë dokumentacionit përcjellës të burgosurve politikë në burgun e Prishtinës, duke marrë parasysh nga ato shënimet e gardianëve që është një pasuri shumë e madhe e hetuesisë, sepse ky burg ka shërbyer si burg hetues dhe ka dokumentacionet e të burgosurve. Vetëm në burgun e Gjilanit, kur unë isha një kohë në vitin 1986, më shumë se 200 të burgosur politikë kanë qenë brenda, prandaj çdo burg hetues që ka qenë në Kosovë e ka vlerën e vet, sepse karakterizohet me një dhunë të pandriçuar.

Lirije Kajtazi, natyrisht për një kërkesë të tillë, besoj se askush nuk rezervohet, sepse është diçka që duhet t'u rrëfëhet gjeneratave, duhet t'i adresohemi institucioneve, për të dhënë mendimin e tyre. Çdo ditë e më shumë edhe qytetarët, por edhe ne përgjegjësit institucionalë po bindemi që nuk duhet të flasë vetëm e kaluara, sepse nuk po mjafton vetëm për të dëshmuar krime, por është e domosdoshme të zhvillohet ky vend, në mënyrë që të ruhet e kaluara e lavdishme. Ne e kemi memorialin e Jasharajve, që në mungesë të dorës institucionale është i rrezikuar të rrënohet, prandaj duhet të shprehim kujdesin sa më të shpejtë, në mënyrë që kjo histori të ruhet për gjeneratat, sidomos për ata që guxojnë të marrin përgjegjësi publike. Unë e përkrahu edhe si deputete e LDK-së, edhe si parti.

Mirjeta Kalludra, tha se shndërrimi i burgut të Prishtinës në muze, mendoj që do të mbetet vlerë e trashëgimisë, duke pasqyruar vuajtjet reale të popullit të Kosovës. Unë si anëtare e komisionit dhe si deputete e LDK-së, e mbështes këtë iniciativë.

Pas diskutimeve, lidhur me këtë çështje, kryetarja konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë:

V e n d i m

Komisioni funksional kërkon nga të gjitha institucionet përgjegjëse që burgu i Prishtinës të shndërrohet ne muze.

2. Të ndryshme

Kryetarja, tha se kemi formuar një këshill organizativ për shënimin e 20 vjetorit në burgun e Dubravës dhe kemi mbajtur edhe një takim, ku prezent ishte drejtori i Agjencisë për Menaxhimin Komplekseve Memoriale të Kosovës, Nait Hasani, Muahrrem Nitaj dhe një përfaqësues i Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit.

Teuta Haxhiu, iniciativën e ka marrë komisioni, për t'u mbajtur një seancë dhe konsideroj që takimi i radhës të mbahet në përbërje të komisionit dhe t'i detajojmë hapat se çka duhet të bëjmë. Nga viti i kaluar që kemi qenë në vizitë, kemi marrë një sugjerim të familjarëve që lapidari nuk është në vendin, ku janë vrarë të burgosurit.

Luljeta Veselaj-Gutaj, në takimin e fundit, kemi diskutuar që të formohet një këshill organizativ. Kryesuesja e këshillit të formojë një këshill me organet kompetente, me emra të caktuar, që ata të punojnë bashkërisht dhe të na raportojnë neve për punën dhe bashkërisht të vazhdojmë tutje.

Shemsi Sylja, tha se ne nuk kemi pasur informacione të plota dhe kemi menduar që po zgjidhet një përfaqësues i komisionit tonë dhe të ketë njerëz që i ndihmojnë brenda komisionit. Ne i kemi pasur disa kërkesa, jo vetëm të shënohet 20 vjetori, por kemi kërkuar edhe vendin se ku do të bëhet lapidari, jo jashtë, por aty ku ka ndodhur ngjarja në burgun e Dubravës. Kemi kërkuar në instanca të larta përgjegjëse, të cilat kanë ndikim, që të lirohet ai vend dhe të burgosurit të tërhiqen nga ai vend dhe në një të ardhme shumë të afërt të bëhet një muze. A ka shteti mundësi që të bëjë një objekt tjetër përcjellës për të burgosurit, në mënyrë që të lëshohet vendi ku ka ndodhur masakra dhe ta shndërrojmë në muze, të shihen faktet se çfarë ka ndodhur në atë burg.

Kryetarja pyeti: çka mund të bëjmë ne, si komision, për rastin e vajzës nga Drenasi, që të mos përsëriten më rastet e njëjta?

Në këtë mbledhje anëtarët e komisionit shprehen shqetësimet e tyre edhe për rastin e vajzës së mitur nga Drenasi.

Kryetarja konstatoi se lidhur me rastin e vajzës së mitur nga Drenasi, në mbledhjen e radhës, të ftohen në raportim kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe i Këshillit Prokurorial.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje